



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË**

VENDIM

NR. 11, datë 27.02:2024

“PËR DHËNIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” PËR Z. ARBEN ISA BAJO(pas vdekjes)”

Në kuadër të vlerësimit të figurës së Z. Arben Isa Bajo si dhe në zbatim të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Neni 54, pika (m) si dhe Ligjit Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit", V.K.M Nr. 861, datë 10/12/2014 "Për miratimin e rregullave të hollësishme për funksionimin e komisioneve këshillimorë për dhënie të medaljeve dhe titujve vendorë të nderit", Këshilli i Bashkisë i mbledhur në datën 27.02 2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, për dhënie tituli "Qytetar Nderi" për Z. Arben Isa Bajo, si dhe mbështetur në relacionin e Komisionit Vendor për Dhënie të Titujve të Nderit,

VENDOSI:

1.Të miratojë dhënie të titullit “Qytetar Nderi” për Z. Arben Isa Bajo (pas vdekjes) me motivacionin:

“Për veprimtarinë shumëvjeçare krijuese në fushën e artit dhe skulpturës, duke krijuar vepra me nivel të lartë artistik, si dhe për kontributin e tij të spikatur në përgatitjen e brezave të rinj në fushën e arteve pamore”.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Trashëgimisë, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” .

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

